VENDIM
Nr. 148, datë 26.12.2014

PËRPËRCAKTIMIN E ÇMIMEVE TË SHITJES ME PAKICË TËENERGJISË ELEKTRIKE PËR KONSUMATORËT TARIFORË PËR VITIN 2015

Në mbështetje të neneve 9 dhe 26 të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, neneve 20 dhe 21 të Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 21, datë 18.3.2009, të ndryshuar, vendimit nr. 80, datë 26.6.2008, "Për miratimin e metodologjisë së llogaritjes së tarifës për furnizuesin publikme pakicë të energjisë elektrike", Bordi i Komisionerëve i Entit Rregullator të Energjisë(ERE), në mbledhjen e tij të datës 26.12.2014, pasi shqyrtoi aplikimin e OSHEE sh.a. për përcaktimin e çmimeve të shitjes me pakicë të energjisë elektrike për konsumatorët tariforë për vitin 2015 dhe relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve,

VENDOSI:

1. Miratimin e çmimeve të shitjes me pakicë të energjisë elektrike për konsumatorët tariforë për vitin 2015, sipas tabelës bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ngarkohet Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit për njoftimin e OSHEE sh.a.

Ky vendim hyn në fuqi në datën 1.1.2015.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti

Tarifat e sherbimeve te shitjes me pakice te energjise elektrike per vitin 2015		
Niveli i tensionit	*Cmimi (leke/kWh)*	*Cmimi pik (leke/kWh)*
Konsumatore ne 35 k V	9.5	10.93
Konsumatore ne 20/10/6 kV	11	12.65
Furra buke dhe prodhim mielli ne 20/10/6 kV	7.1	8.17
Konsumatore ne 0,4 kV	14	16.1
Furra buke dhe prodhim mielli ne 0,4 kV	7.6	8.74
Familjare	9.5	
Tarifa per konsumin e energjise elektrike ne ambjentet e perbashketa (ndricim shkalle, pompe,ashensor)	9.5	
Tarife fikse e sherbimit per leximin "zero" (leke/muaj)	200	

**Cmimi i energjise reaktive eshte sa 15 % e cmimit te energjise aktive*

** Orari pik gjate te cilit do te aplikohet tarifa per energjine e konsumuar ne pik eshte :*

Per periudhen 1 Nentor - 31 Mars nga ora 18:00 deri ne 22:00

Per periudhen 1 Prill - 31 Tetor nga ora 19:00 deri 23 : 00